

VENDIM
Nr. 821, datë 30.12.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 684, DATË 6.11.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE ‘ENTI KOMBËTAR I
OPERIMIT RRUGOR’ SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të vendimit nr. 684, datë 6.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare ‘Enti Kombëtar i Operimit Rrugor’ sh.a.”, shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në programin “Transporti rrugor”, i shtohet fondi në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për rritje të kapitalit të EKORR sh.a.-së, për mbulimin e veprimtarisë operacionale, i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2025.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama